

Vithkuqi, toka e kishave, manastireve dhe shenjtorëve Nga Ilirjan Gjika



Vithkuqi është një zonë malore me lartësi mesatare 1300 m e cila shtrihet në jugperëndim të qytetit të Korçës, në një distancë rreth 20 km prej tij (1) . Pejsazhi impresionues dhe piktoresk të

shoqëron kudo, ku vendi është i rrethuar nga male të larta dhe të veshura me pyje halorë dhe gjethegjërë, midis të cilëve spikasin drurët e bredhit, ahut dhe dushkut. Pikërisht këtu, ngrihen

një sërë fshatrash të njohur si: Lubonja, Gjançi, Leshnja, Shtylla, Roshanji, Çemericë, Rehova, Trebicka, Grabocka, Treska, Stratobërdha dhe Panariti, të cilat përbëjnë sot Njësinë Territoriale-

Administrative Vithkuq, pjesë e Bashkisë së Korçës (2).

Nga masivi malor i Vithkuqit buron edhe lumi Osum, i cili së bashku me Devollin krijojnë Semanin, lumin e dytë për nga gjatësia të Shqipërisë, prej 281 km. Ndërsa Osumi është 161 km i

gjatë dhe piknisja e tij është në fshatin Leshnjë, ku bashkohen përrenjtë e kësaj zone me ata që rrjedhin prej shpatit perëndimor të malit të Gramozit. Pikërisht këtu pranë ngrihet edhe maja

më e lartë që dominon këtë zonë, mali i Rrungajës me një lartësi prej 1945 m (3) .

Por Vithkuqi konsiderohet edhe si vendi i krojeve dhe burimeve të shumta. Nuk janë pak por 100 të tillë, ku ndër më më të njohurit mund të përmendim kroin Mbret, kroin i Kurtiqit, kroin e

Kuq, kroin e Vashës, kroin e Palit, kroin e Ndrios, kroin e Borishtit, kroin e Dukasit, atë të Melasit, Kondasit, etj (4) .

Si një zonë malore e ndërmjetme midis Korçës dhe Skraparit, por edhe shumë pranë Kolonjës,

Vithkuqi, dallohet për dialektin e veçantë dhe tiparet etnografike, ku bien në sy ndërtimet mjeshtërore prej guri, punimet e drurit, ato të leshit, kostumet popullore, këngët, vallet dhe gatimet karakteristike, etj.

Nga pikpamja historike kjo zonë është banuar qysh herët në të cilën, arkeologët, kanë gjetur gjurmë të vjetra që nisin nga periudha antike. Të tilla mund të përmendim një sërë varresh të

shekujve IV-III pk apo kalatë e Bellovodës, Leshnjës, dhe Boshanjit (5) . Më pas, Vithkuqin e ndeshim si vendbanim mesjetar dhe pjesë të principatën së Muzakajve, familja e të cilëve e

kishte origjinën nga Opari fqinj (6) . Me pushtimin osman, fshati shfaqet në dokumenta si mylk i Iljaz Bej Mirahorit, personit që do të shndërronte Korçën në qytet. Por përpara se të bëhej

komandant i stallave të sulltan Bajazitit II, ky njeri quhej Ilia dhe ishte i biri i priftit të fshatit Panarit (7) . Ndërsa në vitin 1505, Iljaz Bej Mirahori, do ta kthente në vakëf Vithkuqin me

Leshnjën, së bashku me fshatrat e tjera që kishte në pronësi

Por shkëlqimin e tij, Vithkuqi e arriti në shekujt XVII-XVIII, kur u shndërrua në një qytet të zhvilluar me tregje, dyqane, hane, tregti dhe zejтари të përmendur. Sipas Kodikut të Korçës dhe

Selasforit, në vitin 1792, ai, përbëhej nga një sërë lagjesh të shumta, si: Borishë, Tatac, Lias, Qyrsash, Syrbash, Grekas, Palas, Kolagjerkas, Kovaças, Saraq, Rusas

dhe Dukas (9) . Në të ishin zhvilluar një sërë mjeshtërish punimi, ku zhvillohej edhe një aktivitet i gjerë tregtar që përshinte edhe vendet e rajonit përreth. Po kështu, Vithkuqi ishte edhe një qendër e njohur arsimore, në shkollën e të cilit jepte mësim edhe murgu Sava, i shkolluar në Akademinë e Voskopojës (10) .

Por njëlloj si Voskopoja, një qendër tjerër e rëndësishme e kësaj zone, ai, do të kishte fatin e keq që do të rrënohej nga një sërë luftërash feudale të kohës. Të tilla ishin një sërë ngjarjesh që

nisën në vitin 1781, dhe vijuan në vitet, 1819, 1823 dhe 1830 (11) .

Janë një sërë dokumentash dhe burimesh historike që dëshmojnë rreth këtyre ngjarjeve, të cilat gjenden të shkruara në kishat e Vithkuqit. Në mbishkrimin e parë që e gjejmë në faqet e ungjillit

të kishës së Shën Mëhillit, (transferuar më pas në kishën e Shën Mërisë), shkruhet se: “Në vitin 1823 tetor 25 Vithkuq. Sipas ungjillit (providencës) vjen zemërimi i perëndisë nga të pabesët.

Në këtë vit u prish ky vend i famshëm, që quhet Vithkuq dhe u bë çdo gjë shkretëtirë”.

Ndërsa në mbishkrimin e dytë, të datës 28 korrik 1828, që ndodhej dikur në hajatin jugor të kishës së Shën Mëhillit, u shkrua nga Dhaskal Kostaq Cepi një tjetër dëshminë, ku midis të

tjerave thuhet: “ Unë, dhaskal Kostaq Cepi erdha nga Berati dhe e gjeta fshatin të rrënuar, të shkretë, shtëpitë të prishura dhe unë i pamerituari i pashë të gjitha shtëpitë pa njerëz, por unë

dhe ju të mjerë e të shkretë pësua mjerimin, dhe cilido që u ndal dhe e prishi fshatin, të kenë mallkimin që i bënë kishat dhe manastiret e shkretë...” (12) .

Kështu pas shkatërrimit të këtyre viteve, Vithkuqi, e humbi rëndësinë e tij dhe u kthye në një vendbanim rural, i cili në mesin e shekullit XIX numëronte 150 shtëpi dhe tre lagje, si: Grekas,

Dukas dhe Saraq. Gjatë kësaj periudhe nisi edhe largimi i banorëve të tij që emigruan jo vetëm drejt vendeve fqinje të Rumanisë, Bullgarisë dhe Greqisë, por edhe deri në SHBA. Po kështu të

njohura janë edhe fshatrat e themeluara nga ky komunitet, si Mandrica në Bullgari apo Lehova në Greqi. Por edhe larg tokës mëmë, vithkuqarët, do të mbanin lidhje të forta me vendlindjen

duke bërë edhe një jetë aktive patriotike dhe kulturore. Është i njohur shembulli që vjen nga Amerika e largët kur në vitin 1910, emigrantët vithkuqarë do të krijojnë shoqatën “Bashkimi i Vëllazërisë” (13) .

Ndërkohë patriotizmi i komunitetit të kësaj zone u shpreh fuqishëm edhe gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Kështu në 29 korrik 1943 në Vithkuq do të krijohej batalioni

partizan “Qamil Panariti”, në të cilin do të rreshtoheshin dhjetra bij dhe bija të kësaj zone.

Ndërsa në 15 gusht po të këtij viti, në pyllin e Makrezës, do të krijohej Brigada I-Sulmuese, si formacioni më i madh i asaj kohe i Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Ndërkohë që në Panarit fqinj do

të strehohej dhe do të punonte gjatë muajve të parë të vitit 1944 edhe Shtabi i Përgjithshëm i saj (14) .

Por gjatë këtyre viteve për shkak të përkrahjes që Vithkuqi i dha luftës partizane, në të do të kthehej përsëri historia dhimbshme e djegieve dhe shkatërrimeve. Një fakt të tillë na e

përkshkruan edhe një dokument autentik, kodiku i kishave të Vithkuqit, i cili ruhet sot në Muzeun Historik Kombëtar. Në fletët e para të tij jepet edhe ky përshkrim i qartë: “Këtu poshtë

po shënojmë se qysh më datë 28. 08. 1943 u sulmua katundi ynë prej ushtrisë italiane që dogji gjithë fshatin, ashtu dhe edhe katër kishat: Shën Kollin, Shën Thanasin, Shën Joanin dhe Shën e

Premten. Në këtë kishë ndodheshin gjithë sendet që shënohen në këtë inventar dhe pothuajse u dogjën të gjitha, përveçse disa sendeve më të vlefshme. Një petrahil që është regjistruar me

numrin 32, kryqi i madh që është regjistruar me numrin 31, dy ungjij që janë

regjistruar me numrin 1, të cilat u ndodhën të mbuluara në një vend të posaçëm dhe mundën të shpëtonin.

Këto sende kanë një vlerë të madhe, ndërsa gjithë të tjerat u dogjën'' (15) . Kjo ishte djegia e pestë dhe e fundit që regjistrohej në analet e këtij vendbanimi të njohur.

Por pavarësisht shkatërrimeve përgjatë kohërave të ndryshme, Vithuqi, ka ditur jo vetëm të mbijetojë por edhe të na befasojë me vitalitetin e tij. Një gjë të tillë e ndeshim edhe në aspektin

ekonomik, ku një ekonomitradicionale të kombinuar me risitë.

Pikërisht këtu, në vitin 1936 u ngrit edhe hidrocentrali i parë në Shqipëri, i cili kishte një kapacitet prodhues prej 500 kilovatësh, si dhe ujësjellësi që furnizonte me ujë qytetin e Korçës.

Ndërsa në Rehovë, gjatë viteve të periudhës së komunizmit do të funksiononte edhe edhe miniera e nxjerrjes së bakrit dhe fabrika e pasurimit të tij. Ndërkohë që në vitet 1970-1975 u

ndërtua edhe liqeni artificial i Gjançit, me qëllim ujitjen e tokave bujqësore të pjesës jugperëndimore të Fushës së Korçës. Me një kapacitet ujëmbledhës prej 18 milion m³ ujë, ky

liqen artificial zë një sipërfaqe të konsiderueshme duke i dhënë një tjetër pamje pejsazhit gjeografik të zones (16) .

Krahas tyre, Vithkuqit, nuk i kanë munguar edhe njerëzit e shquar, ku prej komunitetit të tij kanë dalë me dhjetra personalitete në fusha të ndryshme, laikë dhe klerikë. Një prej tyre ishte

edhe murgu Eustrat Vithkuqari, dijetar dhe mësues që ushtroi aktivitetin e tij në Akademinë e Voskopojës, shkrues librash dhe kodikësh. Ai jetoi gjatë gjysmës së dytë të shekullit XVIII deri në

vitin 1822, ndërsa emri i tij i vërtetë është Jani Strati.

Eustrat Vithkuqari është autor i një gramatike në gjuhët greqisht-shqip-anglisht dhe një fjalori të vogël. Të dyja këto vepra do të botoheshin në vitin 1814 në Londër, si pjesë e librit ''Studime

në Greqi'' të diplomatit anglez pranë Ali Pashë Tepelenës: Uilliam Martin Lik (17) .

Nga Vithkuqi ishte edhe Shën Nikodhimi një nga martirët e rinj të besimit të krishterë në Shqipëri, i cili përpara se të vishte petkun e murgut quhej Nikolla Dede. Ai ishte vendosur dhe

jetonte me familjen në qytetin e Beratit ku ushtronte edhe profesionin e rrobaqepësit. Këtu nga martesë me një grua besimit myslyman ai do të

konfertohej në këtë fe. Por jeta e tij do të ndryshonte kur për të takuar të birin do të udhëtonte drejt Malit të Shenjtë. Pikërisht këtu, në vendin e manastireve do të rikthehej në besimin e të parëve, biles në skitin e Shën Anës, ai, do të shdërrohej në murg duke ju kushtuar shërbesave, lutjeve dhe agjërimit. Me brengën e pendimit, Shën Nikodhimi, u rikthye në Berat për tu treguar njerëzve mrekullitë e besimit të krishterë. Për këtë gjë do të kallëzohej tek kadiu i cili pasi nuk e bindi të hiqte dorë nga besimi urdhëroi ta hidhnin nga maja shkëmbore e kalasë. Por Shën Nikodhimi shpëtoi mrekullisht dhe ju paraqit përsëri atij. Këtë radhë kadiu dha urdhër që ta ekzekutonin me prerjen e kokës, martirizim i cilit u krye në 10 korrik 1709. Pas shpalljes shenjtor do të botoheshin një sërë librash shërbesë dhe kodikësh rreth jetës së Shën Nikodhimit, ndërsa porteti tij do të paraqitej në afreske dhe ikona. Në Vithkuq afresket e tij janë pikturuar në kishën e Shën Kozmait dhe Damianoit si dhe në manastirin e Shën Pjetrit dhe Pavlit (18) .

Nga ky fshat ishte edhe Naum Veqilharxhi, ideologu i Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe pionieri i arsimit kombëtar. I lindur në vitin 1767 në Vithkuq ai do të kalonte vitet e fëmijërisë, ku më pas do të emigronte me familjen fillimisht në Moldavi dhe më pas në Rumani. Pikërisht këtu, në vendin e njohur ballkanik, ai nisi punën për formulimin e një alfabeti të gjuhës shqipe me të cilin botoi në vitin 1844 “Evetarin”, të parën abetare të gjuhës shqipe. Ndërsa dy vjet më vonë, në vitin 1846 hartoi “Enciklikën, e cila ishte një qarkore drejtuar bashkëatdhetarëve ortodoksë në Shqipëri, e cila së bashku me parathënien e Evetarit dhe letrën polemizuese dërguar të nipit, konsiderohen si dokumentet e para me të cilat nis lëvizja e Rilindjes Kombëtare (19) . Sot nga shtëpia e Naum Veqilharxhit në Vithkuq ka mbetur vetëm pusi i saj, i cili shërben si vend identifikimi dhe përkujtimi për figurën e këtij iluministi.

Ndërkohë që në tjetër emër i njohur për kontributet e tij në Rilindjen Kombëtare është edhe Spiro Dine. I lindur në Vithkuq në vitin 1844, ai, pati meritën e organizimit patriotik të shqiptarëve të Egjiptit, vend në të cilin u vendos në vitin 1866. Po kështu, Spiro Dine, shkroi vjersha dhe mblodhi materiale të shumta me karakter folklorik, të cilat u botuan nga Thimi Mitko në vëllimin “Bleta Shqiptare”. Një pjesë të këtij volumi të përbëra prej

këngësh trimërie, vajtimi apo dashurie, doke, zakone, rite dasme, lojëra popullore, gjëgjëza dhe përralla, u përmbledhën në veprën “Valët e detit”, botuar në Sofje në vitin 1908 (20) .

Por këto rrënjë të forta dhe kjo traditë e spikatur e krishtërit shihen jo vetëm te kishat dhe manastiret e shumta por folklori popullor. Një shembull me karakter tregues në këtë drejtim

është edhe legjenda që lidhet me varrin e pagëzimit, e cila e ka marrë emrin nga një histori jetësore e ndodhur në vitin 1751. Është ngjarja e dhimbshme e një familje që vdiq nga të ftohtit

e acartë të dimrit, duke u endur nga njëri skaj në tjetrin në kërkim të një kishe për të pagëzuar foshnjën e sapolindur. Varri që dëshmon këtë gojëdhënë ndodhet në varrezat e fshatit dhe

shquan nga të tjerët nga një kryq monumental prej guri gëlqeror (21) .

Ndërsa një dëshmi tjetër që provon traditën e fortë të besimit është i mbishkrimi i vitit 1696, i cilin gjendet në fasadën e kishës së Ungjillizimit, dedikuar skenësë “Gjyqit të fundit” nga

murgesha Joana.

“Lutja e shërbëtores së perëndisë, murgeshës Joana”, shkruhet në të duke treguar se në manastiret e Vithkuqit nuk kishte vetëm murgj por edhe murgesha të përkushtuara ndaj këtij

shërbimi (22) . Kurse komunitetin e murgjve ndër vite e ndeshim në mbishkrimet e manastirit të Shën Pjetrit dhe Palit. Kështu në vitin 1736 ndeshim emrat e igumenit Metod dhe murgut Anthim, ndërsa në vitin 1762 ndeshim emrin e Tarasit, i cili ishte igumen dhe jeronomak në këtë manastir (23) .

Ndërkohë Vithkuqi ka qënë i njohur edhe për mëse 14 kisha të spikatura për arkitekturën dhe afresket e tyre, prej të cilave deri në prag të Luftës II Botërore ruheshin 11 prej tyre. Ndërsa sot

kanë mbetur në këmbë bazilikat e Shën Mëhillit dhe Shën Mërisë, kishat e Shën Kozmait dhe Damianoit, Shën Minait, të Ungjillizimit, Shën Gjergjit, apo manastirin e Shën Pjetrit dhe

Pavlit (24) . Disa prej tyre funksionojnë jo vetëm si faltore, por gëzojnë edhe statusin si monumente kulture. Të tilla janë kishat e Shën Mërisë, Shën Gjergjit, Shën Mëhillit, manastiri i

Shën Pjetrit dhe Palit, si dhe zonat e mbrojtura rreth tyre (25) . Por le ti shohim ato me radhë nga pikpamja arkitektonike, ndërtimore dhe artistike këto faltore monumentale.

Kisha e Shën Mëhillit është njëkohësisht kisha më e madhe dhe më e vjetër e Vithkuqit. Sipas mbishkrimit që gjendet mbi portën jugore brenda kishës ajo i kushtohet kryeëngjëjve Mikail

dhe Gabriel, ndërtua nga themeli në vitin 1682 dhe pikturuar në vitin 1728 (26) . Faltorja është një bazilikë trenefëshe me përmasa 15,5 x 9.5 m e përbërë nga naosi, altari, nartekso dhe hajati.

Naosi ndahet nga dy radhë kolonash ku nafi qëndror është më i lartë dhe më i gjerë se dy nefet anësorë. Kolonat lidhen midis tyre me një sistem harqesh duke krijuar një bërthamë

kupolash që fshihen nën çatinë dyujëse të bazilikës. Në anën lindore ndodhet absida pesëfaqëshe, ndërsa nartekso është shtuar më vonë në anën perëndimore. Ai përbëhet nga një

radhë kolonash dhe mbulohet nga çati druri pa tavan. Në pjesën jugore bazilika është e pajisur me një hajat përpara të cilit ndodhet një shesh i gjerë. Pranë kishës në pjesën veriore ndodhen

varrezat e fshatit (27) .

Një kishë tjetër e ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit XVII është edhe ajo e Shën Mërisë, e cila përbëhet nga naosi, altari, nartekso dhe hajati. Pjesa më e vjetër e saj i përket naosit një

nefësh me përmasa 7.90 x 4.80 m, i mbuluar me kupolë. Më pas kishës i është shtuar edhe nartekso dhe më pas edhe hajati në pjesën jugore mbështetur mbi shtylla druri. Të dy këto

ambiente janë të mbuluara me çati dhe pa tavan. Ndërsa muratura është ndërtuar me gurë shmërrçi ku përjashtim bën absida shtatë faqëshe ndërtuar me gurë të skuadruar dhe e

zbukuruar me nike (28) .

Ndërsa tre kishat e tjera si ato të Shën Minait, Ungjillizimit dhe Shën Gjergjit nuk ruajnë datat e ndërtimit, por mbishkrime të tjera si ato të ikonostaseve dhe ikonave 29 . Duke u bazuar në to

dhe analizën e tipareve arkitektonike rezulton se këto faltore janë ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit XVIII (30) .

Por padyshim kompleksi më i madh i kultit që ekziston në Vithkuq është padyshim manastiri i Shën Pjetrit dhe Pavlit. I ngritur në kodrën që ndodhet në verilindje të fshatit pranë lagjes së

dikurshme Borishë, ai përbëhet nga kisha e me të njëjtin emër, konakët e shkatërruar gjatë Luftës II Botërore, kisha Shën Kozmait dhe Daminoit dhe varrezat

(31) . Dikur në këtë vend që nga banorët vendas njihet si kalaja mendohet se në antikitet ndodhej një tempull pagan. Ndërkohë të dhënat që na vijnë nga kodiku i qytetit të Vithkuqit, të mbledhura fillimisht nga Ilo Mitkë Qafëzezi dhe të botuara më vonë edhe nga autorë të tjerë, dëshmojnë se manastiri u ngrit mbi një ndërtim më të vjetër në vitin 1710 (32) .

Më pas në vitin 1736 u ngrit kisha e anargjirëve Kozma dhe Damian, fakt që dëshmohet nga mbishkrimi mbi portën brenda saj. E ngritur me muraturë guri në një terren të pjerrët dhe e përbërë prej dy katesh, kisha është një bazilikë njënefëshe me përmasa 12.5 x 4.95 m. Ajo përbëhet prej naosit, altarit dhe narteksit të cilët mbulohen me qemere cilindrike, ndërsa kati i

sipërm lidhen nëpërmjet shkallëve që dalin në narteks me katin nën dhe, që është përdorur si qimiter i manastirit (33) . Ikonat dhe dyert e bukura të ikonostasit të kishës së Shën Kozmait dhe

Damianoit janë pikturuar prej Kostandin Shpatarakut. “Dora e jerodiakon Kostandinit nga Shpati, viti prej Krishtit 1748”, shkruhet në mbishkrimin që gjendet në një prej ikonave të tij (34) .

Ndërsa kisha e Shën Pjetrit dhe Palit u rindërtua në vitin 1759. “Ndaj vitit 1759.... Igumeni i manastirit të shenjtë Tarasi, i biri i Gjikë Bukës, prej mëhallës Qyrso të Qytetit Vithkuq e

përsëriti dhe e ndërtoi nga themelet kishës e apostujve të shenjtë... me gjithë narteksin dhe me tërë kusurin e bukurisë, sikundër shihet sot” (35) .

Për ndërtimin e tij u saj u shpenzuan 500 aspra të cilat ishin mbledhur dhe dërguar nga vithkuqarët kurbetlinj në Hungari 36 . Kisha e Shën Pjetrit dhe Pavlit është një bazilikë me tambur

dhe kupolë e përbërë prej naosit dhe altarit, me përmasa 14.70 x 8.0 m. Naosi përbëhet prej tre nefesh, ku ai qëndror është më i lartë dhe më i gjerë se dy tjerët. Nefi qëndror ndërpritet nga

një nef tërthor mbi të cilët mbështetet tamburi me kupolën. Ndërsa në nefet anësorë, harqet që dalin nga kolonat dhe lidhen me muret e jashtëme mbulohen me kupola sferike (37) .

Kisha është ndërtuar me gurë ngjyrë gri të punuar në forma të rregullta katërkëndore. Me gur smërçi me ngjyrë bezhë janë punuar tri absidat poligonale, këmbanorja dhe disa dritare. Kurse

për mbulimin e çatisë dyujëse janë përdorur rrasa guri (38) .

Sipas mbishkrimit që ndodhet në pjesën e brendshme të portës veriore të kishës së

Shën Pjetrit dhe Palit, kjo faltorje u pikturua me afreske nga piktorët Kostandin dhe Athanas Zografi nga Korça në vitin 1764. Ndërsa ikonostasi është pikturuar në vitin 1748 nga Kostandin Shpataraku (39) . Manastiri kishte një oborr të brendshëm prej 200 m² , i cili rrethohej nga konakët dykatësh në formë U me ambiente të bollshme banimi, shërbimi dhe një dhomë biblioteke. Të shkatëruara prej Luftës II Botërore prej konakëve dhe narteksit të kishës sot kanë mbetur vetëm gjurmët dhe shenjat e mureve të dikurshëm. Ky ent fetar kishte në zotërim prona të shumta që gjendeshin në Vithkuq, Leshnjë, Korçë, dhe Vlorë (40) .

Në çdo 29 qershor, këtu, zhvillohet edhe një festë e traditës me pjesëmarrje të gjerë siç është panairi i përvitshëm i manastirit të Shën Pjetrit dhe Palit. Ndërkohë që një tjetër kremtim që zhvillohet në Vithkuq është edhe përkujtimi i figurës së Shën Nikodhimit. Ai zhvillohet në datën 10 korrik të çdo viti në kishën e re që mban emrin e Shën Nikodhimit, e cila ngrihet në qendër të fshatit në lagjen Dukas. E ndërtuar nën kujdesin e fortlumturisë së tij, kryepiskopit Anastas, guri i parë i kësaj faltoreje u vendos në 10 korrik të vitit 1999, nga mitropoliti i Korçës Joani.

Ky ishte një përshkrim i shkurtër i Vithkuqit, i cili dallohet jo vetëm për historinë, natyrën dhe monumentet kishtare, por edhe për një komunitet ortodoks të përbërë nga njerëz fisnikë dhe punëtorë, të shquar për traditat dhe kulturën e trashëguar. Ata kanë ditur që përmes kohërave dhe situatave të vështira të ruajnë të paprekur edhe besimin e krishterë ortodoks. E ndërsa sot vijojnë të mbeten qëndrestarë dhe të punojë përballë vështirësive dhe sfidave të kohës, duke u përpjekur të vijojnë transmetimin e traditës së shenjtë të Kishës ndër breza.

.....

- 1-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Kisha Orthodhokse , Tiranë 1998, f. 44
- 2-portavendore.al/bashkia-korce
- 3-Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 1985, f. 787, 952
- 4-Gjikë Kurtiqi, Vithkuqi i 100 krojeve dhe 24 kishave, shoqata “Naum Veqilharxhi“, Tiranë, 2008, f. 16
- 5-Petraq Damko, Gjetje rasti nga Vithkuqi, Iliria, 1-2, Tiranë 1991, f. 275-277; korcaregion.com
- 6-Pëllumb Xhufi, Nga Paleologët te Muzakajt, SH. B 55, Tiranë 2009, f. f. 284-286
- 7-Niko Kotherja, Mbi historinë e Korçës, Helga’s Secrets, 2013, f. 10-11
- 8-Niko Kotherja, Mbi historinë e Korçës, Helga’s Secrets, 2013, f. 10-11; Petraq

- Pepo, "Dy dokumente mesjetare mbi Shqipërinë-berati i Bajazitit të II dhe Vakëfnameja e mirahor Iljaz Beut", Buletini për Shkencat Shoqërore, 1956, f. 271-272
- 9-Materiale dokumentare për Shqipërinë e Jugut të shek. XVIII-fillimi i shek. XX (Kodiku i Korçës dhe i Selasforit), II, ASH, Tiranë, 1981, f. 160
- 10-Materiale dokumentare për Shqipërinë e Jugut të shek. XVIII-fillimi i shek. XX (Kodiku i Korçës dhe i Selasforit), I, ASH, Tiranë, 1981, f. 31
- 11-Materiale dokumentare për Shqipërinë e Jugut të shek. XVIII-fillimi i shek. XX (Kodiku i Korçës dhe i Selasforit), II, ASH, Tiranë, 1981, f. 102; Th. Popa, Mbishkrime të Kishave të Shqipërisë, ASH, Tiranë 1998, f. 197-199
- 12-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave të Shqipërisë, ASH, Tiranë 1998, f. 197, 198-199
- 13-korcaregion.com
- 14-Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 1985, f. 1169
- 15-Andrea Llukani, Kodiku i kishave të Vithkuqit, Tiranë 2018, f. 4
- 16-Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 1985, f. 1128, 1169
- 17-Materiale dokumentare për Shqipërinë e Jugut të shek. XVIII-fillimi i shek. XX (Kodiku i Korçës dhe i Selasforit), II, ASH, Tiranë, 1981, f. 164; William M. Leake, Researches en Greece, Londra 1814
- 18-Aurel Plasari, Një kodik i panjohur për Shën Nikodhimin e Beratit, Bibliothecae", 5, Tiranë 2004, f. 13-19
- 19-Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë 1985, f. 1161
- 20-Po aty, f. 195
- 21- korcaregion.com
- 22-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave të Shqipërisë, ASH, Tiranë 1998, f. 163
- 23-Po aty, f. 177, 181
- 24-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, KOASH, Tiranë 1998, f. 46-56
- 25-Databazë e Burimeve Turistike-Qarku Korçë, Turizmi.gov.al
- 26-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave të Shqipërisë, ASH, Tiranë 1998, f. 161
- 27-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Kisha Orthodhokse, Tiranë 1998, f. 48
- 28-Po aty, f. 46-47
- 29-Theofan Popa, Mbishkrime të Kishave të Shqipërisë, ASH, Tiranë 1998, f. 161-162

30-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Kisha Orthodhokse , Tiranë 1998, f. 54-56

31-Po aty, f. 50-51

32-Aleks Papakozma, Manastiri Shën Pjetër dhe Pavli në Vithkuq. Datimi. Urbanistika. Arkitektura. Mjeshtrit e ndërtimit, Monumentet, 1, Tiranë 1983, f. 78-79

33-Th. Popa, Mbishkrime të Kishave të Shqipërisë, ASH, Tiranë 1998, f. 176-177; P. Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Kisha Orthodhokse, Tiranë 1998, f. 51

34-Theofan Popa, Mbishkrime te Kishave të Shqipërisë, ASH, Tiranë 1998, f. 175

35-I. M. Qafëzezi, Kontribut në historinë e qytetit Vithkuq, manastiret e kishëzat, 1956, nr. 1, f. 7, cituar nga Aleks

Papakozma, Manastiri Shën Pjetër dhe Pavli në Vithkuq, Monumentet, 1, Tiranë 1983, f. 79

36-Po aty, f. 80

37-Pirro Thomo, Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Kisha Orthodhokse , Tiranë 1998, f. 50-53

38-Aleks Papakozma, Manastiri Shën Pjetër dhe Pavli në Vithkuq. Datimi. Urbanistika. Arkitektura. Mjeshtrit e ndërtimit, Monumentet, 1, Tiranë 1983, f. 82

39-Theofan Popa, Mbishkrime te Kishave të Shqipërisë, ASH, Tiranë 1998, f. 175, 181

40-Aleks Papakozma, Manastiri Shën Pjetër dhe Pavli në Vithkuq. Datimi.







[Radio “Ngjallja”](#)